

Perceptimi i qytetarëve për integritetin e institucioneve publike në Kosovë



Autori: Shpat Balaj

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë nga sondazhi i Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP). BSBP është një nismë e re rajonale e filluar nga QKSS në vitin 2020, e cila zbatohet në bashkëpunim me Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi dhe Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në Shqipëri, e mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED). BSBP shërben si një instrument për të matur perceptimet e publikut në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi për çështje të ndryshme të lidhura me sigurinë. Të dhënat tregojnë se si qytetarët i perceptojnë apo informohen rreth çështjeve të paraqitura në këtë raport. Si të tilla, pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e QKSS, BCSP, CSDG ose NED.

Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën Angleze.

Financohet nga :



Konsorciumi i drejtuar nga:



Perceptimi i qytetarëve për integritetin e institucioneve publike në Kosovë



PËRMBAJTJA

Përmbledhje ekzekutive	1
Hyrje	2
Besimi i qytetarëve ndaj institucioneve të Sigurisë, Drejtësisë dhe atyre Qendrore	3
Perceptimi i qytetarëve për praninë e korrupsionit në institucionet publike	6
Perceptimi i qytetarëve për punësimin në administratën publike	8
Mesazhet kryesore	9



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Forca e Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, Presidentja e Kosovës dhe Komunitat janë institucionet publike më të besuara në Kosovë, ku mbi 50 për qind e të anketuarve deklaruan se u besojnë apo u besojnë plotësisht këtyre institucioneve. Këto pasohen nga Dogana e Kosovës dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë me 45 për qind të të anketuarve që ndajnë një mendim të tillë. Nga ana tjetër, më pak se 40 për qind e të anketuarve deklaruan se u besojnë apo u besojnë plotësisht Gjykatave, Prokurorisë, Shërbimit Korrektues të Kosovës, Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës. Rezultatet e raportit tregojnë se qytetarët e Kosovës i shohin institucionet e sigurisë më të besueshme me një nivel më të lartë besimi ndaj tyre, krahasuar me institucionet e tjera publike në Kosovë, siç janë institucionet e drejtësisë, të cilat qytetarët i perceptojnë si më pak të besueshme dhe me integritet të dobët. Besimi i qytetarëve në institucionet e gjykatave dhe prokurorisë në Kosovë është në rënie të vazhdueshme dhe kjo është shqetësuese. Qytetarët kanë shkallë më të lartë besimi te institucionet publike të nivelit qendror, veçanërisht në krahasim me vitin paraprak (2020), mirëpo, skepticizmi ndaj këtyre institucioneve mbizotëron në përgjithësi.

Perceptimi i qytetarëve për praninë e korrupsionit në institucionet publike përkon me perceptimin e tyre për besimin tek institucionet. Sa më i ulët të jetë besimi ndaj një institucioni, aq më i lartë është perceptimi se korrupsioni është i pranishëm në institucionin përkatës. Në përputhje me këtë, institucionet e Sigurisë perceptohen të jenë më pak të korruptuara në krahasim me institucionet e tjera. Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Policia e Kosovës perceptohen të jenë institucionet më pak të korruptuara me më pak se 25 për qind të të anketuarve që deklarojnë se këto dy institucione janë të korruptuara apo shumë të korruptuara, pasuar nga komunitat me 33 për qind të të anketuarve që ndajnë mendimin se komunitat janë të korruptuara. Nga ana tjetër, më shumë se 45 për qind e të anketuarve e perceptojnë Qeverinë e Kosovës, Gjykatat dhe Prokurorinë si të korruptuar dhe shumë të korruptuar.

Së fundi, të të anketuarit e BSBP vërehet një nivel i lartë i skepticizmit lidhur me kompetencën e punonjësve të administratës publike. Shumica e të anketuarve të BSBP besojnë se vetëm një grup i vogël i individëve janë punësuar në administratën shtetërore thjesht në bazë të meritave dhe kualifikimeve. Ndonëse në nivel pak më të ulët, qëndrime të ngjashme janë të pranishme edhe në raport me institucionet e sigurisë. Më shumë se 50 për qind e të anketuarve mendojnë se vetëm një pjesë e të punësuarve në institucionet e sigurisë janë aty falë meritave dhe kualifikimeve.



HYRJE

Besimi i qytetarëve në institucionet publike dhe integriteti i këtyre të fundit janë gurët themeltarë të një shoqërie demokratike dhe transparente. Në këtë kontekst, perceptimet e qytetarëve për institucionet publike janë shumë të rëndësishme për llogaridhënien e sektorit publik. Së këndejmi, ky raport ofron një pasqyrë të rezultateve të anketës publike me qytetarët e Kosovës mbi besimin e tyre në institucionet publike në Kosovë dhe si i kuptojnë ata çështjet e ndryshme që lidhen me integritetin në sektorin publik. Duke reflektuar opinionet dhe qëndrimet e qytetarëve, ky raport ofron bazën për projektimin e një qasjeje të qeverisjes dhe politikave me fokus te qytetari. Raporti përbëhet nga tri pjesë. Pjesa e parë diskuton rezultatet e perceptimeve të publikut në Kosovë ndaj institucioneve të sigurisë, drejtësisë dhe institucioneve publike në nivelin qendror. Pjesa e dytë, shqyrton perceptimin e qytetarëve në lidhje me përhapjen e korrupsionit në institucionet publike, dhe pjesa e tretë fokusohet në perceptimet e qytetarëve lidhur me procesin e punësimit në administratën publike.

Për sa i përket metodologjisë, të dhënat për këtë raport janë mbledhur në kuadër të anketës së Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP) përmes intervistave ballë për ballë me të anketuar të përzgjedhur rastësisht në mbarë Kosovën. Hulumtimi në terren është kryer nga data 17 shtator deri më 25 shtator 2021. Pyetësori i anketës përbëhej kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës Likert me pesë pikë, të pasuara nga disa pyetje të hapura pa opsione të paracaktuara. Mostra kombëtare për anketën përfshinte 1,197 ekonomi familjare. Faza e parë e marrjes së mostrës u bazua në njësitë administrative të drejtorive rajonale të Policisë së Kosovës, duke përfshirë tetë rajonet: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Numri i anketave të kryera në secilin rajon është marrë në proporcion me numrin e popullsisë për secilën komunë brenda rajoneve përkatëse bazuar në regjistrimin e popullsisë së Kosovës në vitin 2011. Brenda komunave, mostra u shtresua në mostër urbane/rurale bazuar në numrin e ekonomive familjare në secilën zonë. Për përzgjedhjen e ekonomive familjare brenda vendeve të marra mostër janë përdorur modele të rastësishme, ndërsa rastësia brenda ekonomive familjare është bazuar në metodën e ditëlindjes më të afërt të personave të moshës madhore. Të dhënat u verifikuan në kohë reale nga koordinatorët në terren që vizituan një mostër të paracaktuar të ekonomive familjare pas përfundimit të anketimit në ekonomitë familjare përkatëse, nëpërmjet kontaktit telefonik me të gjithë të anketuarit për të konfirmuar respektimin e metodologjisë dhe disa nga përgjigjet kyçe, si dhe duke analizuar konsistencën logjike të përgjigjeve gjatë përpunimit dhe analizimit të të dhënave. Marzha e gabimit është 3 për qind me një interval besueshmërie prej 95 për qind.

BESIMI I QYTETARËVE NDAJ INSTITUCIONEVE TË SIGURISË, DREJTËSISË DHE ATYRE QENDRORE



Anketa e BSBP mat besimin e qytetarëve të Kosovës ndaj institucioneve të ndryshme publike. Institucionet kryesore të paraqitura në këtë raport janë të kategorizuara si vijon:

- **Institucionet e Sigurisë** – (Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Policia e Kosovës (PK), Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), Dogana e Kosovës (DK) dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK)¹);
- **Institucionet e Drejtësisë** – (Prokuroria dhe Gjykatat);
- **Institucionet Qendrore dhe Lokale** – (Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës, Presidentja e Kosovës dhe Komunitet).

Në krahasim me edicionin e mëparshëm të BSBP, ka një rritje të përgjithshme të besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve publike. Institucionet e sigurisë perceptohen më të besueshme nga qytetarët në krahasim me ato të gjyqësorit dhe institucionet qendrore. Në këtë aspekt, përkundër faktit se vetëm 13 për qind e të anketuarve deklaruan se kanë pasur kontakt të drejtpërdrejtë me Forcën e Sigurisë së Kosovës në 12 muajt e fundit, ajo mbetet institucioni më i besuar me 82 për qind të të anketuarve që deklaruan se kanë besim apo besim të plotë të FSK. Po kështu, Policia e Kosovës renditet si një ndër institucionet më të besuara në Kosovë. Rreth 70 për qind e të anketuarve të BSBP deklaruan se kanë besim ose besim të plotë të PK. PK është gjithashtu institucioni i sigurisë me të cilin të anketuarit e BSBP kanë pasur më së shumti ndërveprime; 32 për qind e të anketuarve deklaruan se kanë pasur kontakt të drejtpërdrejtë me këtë institucion në 12 muajt e fundit. Nga ana tjetër, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është institucioni i sigurisë që ka shënuar rritjen më të madhe të besimit të qytetarëve në krahasim me vitin e kaluar. Ndërsa në vitin 2020 vetëm 29 për qind e të anketuarve të BSBP shprehën besim apo besim të plotë në këtë institucion, në anketën e vitit 2021, 44 për qind e të anketuarve shprehën këtë mendim. Për më tepër, 44 për qind e të anketuarve të BSBP i besojnë apo i besojnë plotësisht Doganës së Kosovës, ndërsa 40 për qind kanë mendim të tillë për Shërbimin Korrektues të Kosovës. Besimi ndaj të dyja këtyre institucioneve është rritur për gjashtë për qind krahasuar me vitin e kaluar.

Qytetarët janë të prirë të jenë më skeptikë ndaj Gjykatave dhe Prokurorisë dhe ky rezultat ka dalë në mënyrë konsistente në kuadër të BSBP në rastin e Kosovës. Për sa i përket rezultateve më të fundit, ato tregojnë se 31 për qind e të anketuarve të BSBP kanë besim apo besim të plotë të Gjykatat, ndërsa 30 për qind kanë bindje të tilla për Prokurorinë. Megjithatë, përkundër nivelit më të ulët të besimit në krahasim me institucionet e sigurisë, niveli i mosbesimit ndaj këtyre dy institucioneve është ulur nga viti i kaluar. Ndërsa në anketën e BSBP të vitit 2020, 44 për qind e të anketuarve deklaruan se kanë shumë pak besim ose aspak besim të Gjykatat dhe 39 për qind ndaj Prokurorisë, në vitin 2021, 37 për qind e të anketuarve kanë një mendim të tillë për të dyja. Rezultatet tregojnë qartë se ka nevojë për një ndryshim në sektorin e Drejtësisë për të trajtuar mungesën e besimit publik në punën e tyre. Një nga objektivat e Qeverisë aktuale të Kosovës është reformimi i sektorit të Drejtësisë, me fokus në përmirësimin e integritetit nëpërmjet procesit të vettingut.² Megjithatë, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)


1. SHKK dhe DK janë subjekt i analizës së BSBP që nga viti 2019. Përkundër faktit se operojnë nën ministri të ndryshme që nuk kanë të bëjnë me sigurinë, integriteti i tyre në BKS si institucione të sigurisë lidhet me kontributin e tyre në siguri, si dhe me faktin se shërbejnë si staf i sigurisë me uniforme. Për më shumë informacion se pse kategorizohen si të tilla, ju lutemi lexoni edicionin e nëntë të BKS: https://akss.org/images/uploads/files/BKS2019_874685.pdf

2. Shehu, B., 2021. A ka skepticizëm për vetting në sistemin e drejtësisë në Kosovë?. Deutsche Welle (DW). Në dispozicion këtu: <https://www.dw.com/sq/a-ka-skepticiz%C3%ABm-p%C3%ABr-vetting-n%C3%AB-sistemin-e-drejt%C3%ABsis%C3%AB-n%C3%AB-kosov%C3%AB/a-59724252>

po i rezistojnë një procesi të tillë dhe po refuzojnë të bashkëpunojnë me Qeverinë në këtë drejtim, ndërsa BE dhe opozita në Kosovë po kundërshtojnë reformën në Drejtësi nëpërmjet vetting-ut.³ Mosreformimi i sektorit të Drejtësisë potencialisht mund të përkeqësojë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve dhe kjo është e dëmshme për sundimin e ligjit.

Trendi i rritjes së besimit reflektohet edhe në institucionet qendrore edhe në ato lokale. Për dallim nga rezultatet e BSBP të vitit 2020, kur vetëm 13 për qind e të anketuarve deklaruan se i besojnë Qeverisë së Kosovës, në anketën e vitit 2021, janë 36 për qind të të anketuarve që deklaruan se i besojnë ose i besojnë plotësisht Qeverisë, ndërsa 41 për qind kanë shumë pak ose aspak besim në raport me Qeverinë. Një perceptim i ngjashëm vërehet edhe për Kuvendin e Kosovës. Janë 33 për qind të të anketuarve që deklaruan se i besojnë ose i besojnë plotësisht këtij institucioni, ndërsa 42 për qind nuk kanë aspak besim ose kanë shumë pak besim ndaj Kuvendit. Nga ana tjetër, institucioni i Presidentes të Kosovës ka shënuar rritjen më të ndjeshme të besimit krahasuar me vitin 2020. Ndërsa në vitin 2020 shumica e të anketuarve, gjegjësisht 63 për qind, deklaruan se kanë shumë pak besim ose aspak besim te institucioni i Presidentit, në vitin 2021 përqindja e mosbesimit ndaj institucionit të Presidentes ka rënë në 28 për qind. Shumica e të anketuarve, përkatësisht 55 për qind e tyre, kanë besim apo besim të plotë te ky institucion, duke e bërë atë institucionin me shkallën më të lartë të besimit ndër institucionet e sektorit publik. Komunitat gjithashtu kanë një përqindje të lartë besimi me 52 për qind të të anketuarve që deklarojnë se kanë besim apo besim të plotë ndaj Komunitatit. Në të njëjtën kohë, Komunitat janë institucionet me të cilat qytetarët kanë pasur më së shumti ndërveprim. Në këtë aspekt, 53 për qind e të anketuarve deklaruan se kanë pasur kontakt të drejtpërdrejtë me komunitat e tyre përkatëse në 12 muajt e fundit.


TABELA 1 REZULTATET E BSBP - BESIMI NDAJ INSTITUCIONEVE KYÇE TË SIGURISË, DREJTËSISË DHE ATYRE QENDRORE




3. Po aty




SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS




PROKURORIA




GJYKATAT




QEVERIA E KOSOVËS




KUVENDI I KOSOVËS



PRESIDENTTJA E KOSOVËS



KOMUNAT






PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR PRANINË E KORRUPSIONIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE

Rezultatet e anketës së BSBP tregojnë se qytetarët e Kosovës vazhdojnë të perceptojnë korrupsionin si një nga dukuritë kryesore që kërcënon sigurinë kombëtare të Kosovës. Në këtë aspekt, 81 për qind e të anketuarve besojnë se korrupsioni paraqet kërcënim apo kërcënim të madh për Kosovën. Po ashtu, kapja e shtetit shihet nga qytetarët e Kosovës si kërcënim apo kërcënim i madh për sigurinë kombëtare të Kosovës. Për nevojat e anketës, kapja e shtetit u përkufizua si rrethanat politike ku interesat e qytetarëve i nënshtrohen interesave private të individëve në pushtet, si dhe të partnerëve të tyre politikë dhe ekonomikë. Në këtë drejtim, 82 për qind e të anketuarve janë deklaruar se kapja e shtetit paraqet kërcënim apo kërcënim të madh për sigurinë kombëtare të Kosovës.

TABELA 2 REZULTATET E BSBP - PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR KORRUPSIONIN DHE KAPJEN E SHTEJIT SI KËRCËNIME TË SIGURISË KOMBËTARE




Rezultatet e BSBP tregojnë se sa më i lartë të jetë besimi i qytetarëve ndaj një institucioni, aq më i ulët është perceptimi për praninë e korrupsionit në institucionin përkatës. Rrjedhimisht, të anketuarit për qëllime të BSBP i perceptojnë institucionet e drejtësisë dhe institucionet qendrore si më të korruptuara në krahasim me institucionet e sigurisë. Në këtë kontekst, sipas të anketuarve të BSBP, FSK është institucioni publik më pak i korruptuar në Kosovë, me 77 për qind të të anketuarve që deklaruan se FSK është shumë pak ose aspak e korruptuar, kundrejt vetëm 9 për qind të të anketuarve që e perceptojnë atë si shumë të korruptuar ose të korruptuar. Ndërsa, 23 për qind e të anketuarve besojnë se PK është e korruptuar ose shumë e korruptuar, për dallim nga 52 për qind të të anketuarve që mendojnë se është pak ose aspak e korruptuar. Nga ana tjetër, ngjashëm me trendin e evidentuar në edicionin e kaluar të BSBP, Gjykatat dhe Prokuroritë mbeten të korruptuara nga këndvështrimi i qytetarëve. Janë 48 për qind të të anketuarve që besojnë se Gjykatat janë të korruptuara apo shumë të korruptuara, ndërsa 47 për qind e kanë një mendim të tillë për Prokurorinë. Vetëm një e katërta e të anketuarve besojnë se këto dy institucione nuk janë të korruptuara, përkatësisht 24 për qind janë të mendimit se Gjykatat janë pak ose aspak të korruptuara, ndërsa 25 për qind ndajnë këtë mendim për Prokurorinë.

Për sa i përket institucioneve qendrore dhe lokale, ndryshe nga kapitulli i anketës për besimin

ndaj institucioneve publike, perceptimi për praninë e korrupsionit është matur vetëm për Qeverinë dhe Komunat. Në këtë aspekt, Qeveria e Kosovës vazhdon të perceptohet si e korruptuar, ndonëse ka pasur një ulje të ndjeshme të perceptimit për praninë e korrupsionit në këtë institucion krahasuar me vitin e kaluar. Ndërsa në vitin 2020, të anketuarit e BSBP renditën Qeverinë si institucionin më të korruptuar në Kosovë me 63 për qind të të anketuarve që kishin ndarë mendimin se është e korruptuar apo shumë e korruptuar, të anketuarit e këtij edicioni të BSBP e kanë renditur në nivel të ngjashëm me institucionet e Drejtësisë. Përkatësisht, 45 për qind e të anketuarve besojnë se Qeveria është e korruptuar ose shumë e korruptuar, ndërkaq 31 për qind ndajnë mendimin se është pak ose aspak e korruptuar. Për më tepër, 33 për qind e të anketuarve janë të mendimit se Komunat janë të korruptuara ose shumë të korruptuara, për dallim nga 40 për qind që besojnë se Komunat janë shumë pak ose aspak të korruptuara.

TABELA 3 REZULTATET E BSBP - PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR PRANINË E KORRUPSIONIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE




PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR PUNËSIMIN NË ADMINISTRATËN PUBLIKE



Në kontekstin e integritetit institucional dhe qeverisjes së mirë, anketa e BSBP ka matur perceptimin e qytetarëve të Kosovës lidhur me procesin e punësimit në administratën publike, me fokus të veçantë në institucionet e sigurisë. Qytetarët shfaqin shkallë të lartë skepticizmi për aftësinë e punonjësve të administratës publike (nëpunësve publikë). Shumica e të anketuarve të BSBP, gjegjësisht 70 për qind e tyre, besojnë se vetëm një pjesë e zyrtarëve publikë janë punësuar në bazë të meritave. Për më tepër, 6 për qind e të anketuarve besojnë se asnjë nga zyrtarët publikë nuk është punësuar në bazë të meritave dhe kualifikimeve, ndërsa 21 për qind mendojnë se shumica ose të gjithë zyrtarët publikë janë punësuar falë kualifikimeve të tyre. Është e rëndësishme të theksohet se përkundër përpjekjeve të Qeverisë për të promovuar meritokracinë në procesin e punësimit në sektorin publik, duke përfshirë bashkëpunimin me Ambasadën Britanike në Kosovë, e cila ka kontraktuar një kompani të specializuar për mbikëqyrjen e procesit të punësimit për pozitat e larta në administratën publike, perceptimi i qytetarëve se vazhdon të mungojë punësimi i bazuar në merita në administratën publike nuk ka ndryshuar.

Për sa i përket punonjësve të institucioneve të sigurisë ka një perceptim më pozitiv në mesin e qytetarëve. Janë 56 për qind të të anketuarve që mendojnë se vetëm një pakicë e punonjësve në institucionet e sigurisë janë punësuar në bazë të meritave dhe kualifikimeve, ndërsa 28 për qind besojnë se shumica janë të kualifikuar dhe arsyetojnë postet publike që mbajnë. Një anketë e ngjashme e kryer nga UNDP në maj 2021, tregon rezultate të ngjashme me ato të BSBP.⁴ Më shumë se gjysma e të anketuarve në këtë anketë ndajnë mendimin se lidhjet politike dhe familjare, por edhe ryshfeti, janë faktorët kryesorë në punësimin në administratën publike. Anketa e UNDP tregon se të gjitha grupet etnike në Kosovë ndajnë pikëpamje të ngjashme në lidhje me punësimin e bazuar në merita, ku shkalla më e lartë e skepticizmit vërehet në mesin e serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës.

TABLE 4 REZULTATET E BSBP – PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR PUNËSIMIN NË SEKTORIN PUBLIK



4. Për hollësi rreth metodologjisë dhe rezultateve të kësaj ankete, shih këtu: <https://kosovoteam.un.org/sites/default/files/2021-08/PUBLICPULSEBRIEF-ALB.pdf>



MESAZHET KRYESORE

Rezultatet e BSBP tregojnë se qytetarët mbështeten në punën e institucioneve të caktuara, siç është Policia e Kosovës, prandaj kjo do të duhej të shihet si një mundësi për të zhvilluar më tej marrëdhëniet e tyre me qytetarët. Për shembull, në rastin e Policisë së Kosovës, besimi që gëzojnë ata në mesin e qytetarëve do të duhej të shërbejë si mjet për forcimin e mekanizmave siç është policimi në komunitet. Nga ana tjetër, institucionet si AKI, i konsiderojnë normale nivelet e ulëta të besimit për shkak të mungesës së informimit publik për punën e tyre. Ata vlerësojnë se rritja e besimit ndaj tyre vjen edhe si rezultat i njohjes së kontributit të tyre për sigurinë kombëtare në raportet e Departamentit të Shtetit të SHBA dhe raportet e BE, si dhe falë deklaratave publike të institucioneve të tjera për bashkëpunim efektiv me këtë institucion. Ata japin një shembull të mirë të reflektimit mbi opinionet e qytetarëve pasi kanë deklaruar se planifikojnë të fillojnë publikimin e raporteve vjetore, në mënyrë që të jenë më të dukshëm për qytetarët dhe të ofrojnë një bazë që qytetarët të vlerësojnë punën e tyre bazuar në informacione të përditësuara.⁵ Në këtë drejtim, rezultatet e anketës dhe reflektimet e institucioneve mbi këto rezultate theksojnë gjithashtu nevojën për rritjen e dukshmërisë së punës së institucioneve të caktuara dhe qartësimin e mandatit të tyre. Në shumë raste, sidomos në zonat rurale, qytetarët janë shprehur se nuk e ndjejnë fare prezencën e institucioneve, ndërkohë që u mungon edhe informacioni se sa është i kufizuar mandati i institucioneve të ndryshme.⁶

Nga ana tjetër, sidoqoftë, rezultatet e perceptimit për korrupsionin dhe integritetin në institucionet publike do të duhej të shërbejnë për t'i dhënë prioritet luftës kundër korrupsionit. Institucionet nuk do të duhej të jenë të vetëkënaqura me perceptimin e qytetarëve në këtë drejtim, por të fokusohen në forcimin e mëtejshëm të mekanizmave për parandalimin e korrupsionit. Në këtë kontekst, edhe pse FSK nga qytetarët perceptohet si institucioni me më pak potencial për korrupsion, sipas treguesve të Transparency International sektori i Mbrojtjes në Kosovë ka një potencial shumë të lartë për korrupsion.⁷ Rrjedhimisht, edhe institucionet që gëzojnë një perceptim pozitiv nga qytetarët, duhet të punojnë në mënyrë aktive në minimizimin e potencialit për cenimin e integritetit institucional. Për më tepër, besimi i ulët i shprehur në vazhdimësi ndaj institucioneve të Drejtësisë dhe perceptimi se ato vetë janë të korruptuara mund të jenë tregues të nevojës për forcimin e integritetit brenda këtyre institucioneve, përmirësimin e efektshmërisë në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit dhe forcimin e mëtejshëm të mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm anti-korrupsion për të siguruar integritet dhe efektivitet të vazhdueshëm të këtyre institucioneve dhe luftës kundër korrupsionit në përgjithësi.

5. Grupi i fokusit me palët e interesit. 27 tetor 2021, Prishtinë.

6. Grupi i fokusit me hulumtuesit në terren. 25 tetor 2021, Prishtinë.

7. Steadman, M., 2021. Indeksi i Integritetit të Sektorit të Mbrojtjes. Transparency International, [online] Në dispozicion këtu: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2021/11/Kosovo_GDI-2020-Brief-ALB.pdf>

Katalogimi në botim **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës - "Pjetër Bogdani"

35(496.51)"2022"(047)

Balaj, Shpat

Perceptimi i qytetarëve për integritetin e institucioneve publike në Kosovë : anketa e WBSB në Kosovës : raporti i vendit #1 2022 / Shpat Balaj. - Prishtinë : QKSS, 2022. - 15 f. : ilustr. ; 24 cm.

Administrata shtetërore -- Raporte -- Kosovë -- 2022

ISBN 978-9951-799-50-8

Aleph [000100498]



ISBN 978-9951-799-50-8

